

NJOFTIM PËR RISHPALLJEN E VENDIT VAKANT PËR KRYETAR TË KËSHILLIT DREJTUES TË RTSH-së (KDRTSH)

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në mbledhjen e datës 26 janar 2021, mbështetur në nenet 93 dhe 94 të ligjit nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” si dhe në nenin 34 të Rregullores së Kuvendit, me vendimin nr. 1 vendosi **“Rishpalljen e vendit vakant për Kryetar të Këshillit Drejtues të RTSH-së”**.

A. Ftohen për paraqitjen e kandidaturave për Kryetar të Këshillit Drejtues të RTSH-së, subjektet e mëposhtme:

- a) Çdo shtetas që plotëson kushtet e neneve 93 dhe 97 të ligjit
- b) shoqatat dhe grupimet e mediave elektronike;
- c) shoqatat e medias së shkruar;
- ç) profesoratin dhe shoqatat e inxhinierisë elektrike dhe elektronike;
- d) profesoratin e së drejtës, gazetari-komunikimit dhe ekonomisë, shoqatat e juristëve dhe Dhomën Kombëtare të Avokatisë;
- dh) organizatat jofitimprurëse që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, të drejtave të fëmijëve ose kërkimeve në politikat publike, ose përfaqësues të shoqatave që veprojnë në fushën e mbrojtjes së personave me aftësi të kufizuar.

B. Subjektet e mësipërme duhet t’i propozojnë kandidaturat pranë sekretarisë së Kuvendit brenda 20 ditëve nga publikimi i këtij njoftimi. Afati i fundit për paraqitjen e kandidaturave është data **17 shkurt 2021.**

C. Propozimi i çdo kandidature duhet të përmbajë:

1. CV-në e nënshkruar në çdo faqe nga kandidati.
2. Librezë pune ose vërtetime të tjera që provojnë përmbushjen e kriterit ligjor të përvojës në punë prej jo më pak se 10 vitesh në fushat e:
 - a) medias në përgjithësi;
 - b) transmetimeve audiovizive të shërbimit publik, tregtar ose jotregtar;
 - c) prodhimit të përmbajtjes së transmetimeve audiovizive;
 - ç) teknologjive të medias;
 - d) ekonomisë, administrimit dhe rregullave të konkurrencës;
 - dh) çështjeve të zhvillimit të gjuhës shqipe;
 - e) çështjeve që lidhen me personat me aftësi të kufizuar e grupeve të tjera vulnerabël;
 - ë) artit, kulturës e muzikës;
 - f) drejtësisë, ligjit, administrimit publik;
 - g) shkencës, mjedisit dhe zhvillimit teknologjik;
 - gj) mbrojtjes së konsumatorit;
 - h) veprimtarive shoqërore, edukuese dhe zhvillimit të bashkësive lokale, publike e kombëtare, të cilat kanë lidhje ose ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi qëllimet e veprimtarisë audiovizive.
3. Vërtetim i gjendjes gjyqësore.
4. Formularin e vetëdeklarimit në zbatim të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë si dhe bashkëlidhur këtij njoftimi.
5. Formularin e plotësuar në zbatim të ligjit nr.45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish – Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i cili gjëndet bashkëlidhur këtij njoftimi.

6. Formular deklarimi papajtueshmërie dhe konfliktit interesi, në përputhje me përcaktimet e nenit 97, pika 1, shkronjat a) dhe b).